

dhjetor 2023

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin nëntor

2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin nëntor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, dhjetor 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit nëntor 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i shtatëmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

1

KATEGORITË KRYESORE
Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Monitorimi i përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara gjatë muajit nëntor (88 përmbajtje) na tregon se më së shumti janë krijuar dhe shpërndarë artikuj “clickbait” gjatë këtij muaji. Kjo kategori pasohet nga dezinformata dhe lajmi i rremë, si tre kategoritë me përqindjen më të lartë.

Përderisa në muajin tetor kishim mbizotërim të përmbajtjeve të paverifikuara lidhur me konfliktin Izrael-Hamas të nisur me 7 tetor, në muajin nëntor rikthehet mbizotërimi i përmbajtjeve “clickbait”. Edhe pse konflikti Izrael-Hamas po vazhdon përmbajtjet keqinformuese lidhur më të janë reduktuar duke i lënë kategorisë “clickbait” mbizotërimin gjatë muajit nëntor. Në bazë të këtij krahasimi, del se artikujt “clickbait” janë mënyra më e shpeshtë të keqinformimit, të cilat zbehen në raste kur kemi të bëjmë me zhvillime nga fusha e sigurisë ndërlidhur me veriun apo edhe ngjarje ndërkombëtare si konfliktit Izrael-Hamas apo edhe tërmeti në Turqi (gjatë muajit shkurt 2023).

Përderisa gjatë muajit tetor (2023) përmbajtjet e paverifikuara ishin në krye të kategorive të keqinformimit, gjatë muajit nëntor (2023) përmbajtjet “clickbait” radhiten si të parat me 32%, pasuar nga dezinformata 26%. Këto dy kategori

pasohen nga lajmi i rremë me 17%, mashtrimi me 11%. Edhe pse në muajin paraprak (tetor 2023) publikimet e vlerësuara si përmbajtje e paverifikuar radhiteshin në vendin e parë, në këtë muaj (nëntor 2023) ato radhiten në vendin e pestë me 11%.

Përmbajtjet keqinformuese të vlerësuara si “clickbait” janë shtuar gjatë muajit nëntor për arsye të publikimeve të përmbajtjeve keqinformuese në fushën e kronikës së zezë, kryesisht nga portalet informative (media digjitale). Ndërsa dezinformatat kryesisht janë publikuar në fushën e sigurisë nga publikues të ndryshëm në mediat sociale.



32% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “clickbait”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. “Clickbait”

Të gjitha përmbajtjet e trajtuara të cilat janë vlerësuar si “clickbait” janë publikuar nga media në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e tyre janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe sociale. Artikuj të ndryshëm të kronikës së zezë për raste tragjike, vrasje, aksidente kanë mbizotëruar në këtë kategori të vlerësimit. Këto përmbajtje, ndërlidhen me ngjarje që nuk kanë ndodhur në Kosovë dhe që në titujt e tyre nuk bëhet e ditur vendndodhja e ngjarjes, duke lënë hapësirë për nxitje klikimesh dhe keqinformim. Ndërkaq, clickbait artikujt për tematikat sociale ishin përmbanin informacione për shërbime me pagesë të rrjeteve sociale Instagram dhe Facebook dhe vendimin për ndaljen e pirjes së duhanit. Por, të gjitha këto, nuk ndërlidheshin më zhvillime në Kosovë. Pra, informacione irelevante për audiencën kosovare që përdorën vetëm për rritje të klikueshmërisë. Krahas këtyre, janë publikuar edhe “clickbait” artikuj lidhur me ndeshjen futbolistike Kosovë-Izrael, me pretendime të rreme që ndërlidheshin me sigurinë e futbolistëve. U manipuluan edhe informacione lidhur me grevën e minatorëve të minierës së Trepçës, dhe tema tjera nga politika e shëndetësia.

02. Dezinformatë

Dezinformatat e trajtuara gjatë muajit nëntor (2023) janë publikuar nga mediat sociale (17%), portalet e dyshimta (6%) dhe media (3%). Përmbajtjet e vlerësuar si dezinformata janë publikuar kryesisht nga fusha e sigurisë, pasuar nga ajo sociale dhe e politikës. Në fushën e sigurisë u dezinformua kryesisht rreth konfliktit Izrael-Hamas me publikimin e fotografive dhe imazheve dezinformues në mediat sociale. Ndërkaq, nga fusha sociale u dezinformua rreth kërkesave për punë në Zvicër. Në fushën e politikës u dezinformua me deklarata të pathëna të deputetes, Ganimete Musliu rreth Qeverisë Kurti dhe presidentit të SHBA-s, Joe Biden për Kosovën.

03. Lajm i rremë

Pothuajse të gjitha lajmet e rreme të trajtuara janë publikuar në mediat sociale, kryesisht në TikTok. Këto përmbajtje të rreme kryesisht ishin nga fusha e sigurisë, pasuar nga kronika e zezë, politika, sporti dhe socialja. Nga fusha e sigurisë, u publikuan lajme të rreme për armatosjen e FSK-së me helikopterë, aeroplanë dhe automjete ushtarake. Ndërsa, në fushën e kronikës së zezë u publikuan lajme të rreme për tërmet në Shqipëri dhe për vdekjen e 10 shqiptarëve nga një tornado në Gjermani. Nga fusha e politikës vlen të përmendet publikimi i një lajmi të rremë në mediat sociale për gjendjen shëndetësore të ish-presidenti, Hashim Thaçi. Në fushën e sportit u publikua një imazh me inteligjencë artificiale që pretendohet se paraqitet një projekt për ndërtimin e një stadiumi në Prishtinë. Në fushën sociale u publikua një përmbajtje e rreme e ndërlidhur me konfliktin Izrael-Hamas.

05. Përmbajtje e paverifikuara

Publikuesit e përmbajtjeve të paverifikuara janë kryesisht nga mediat sociale. Ndërsa temat e përdorura për këto përmbajtje janë nga fusha e sociale. Përderisa në gjuhën shqipe përmbajtjet e paverifikuara u publikuan në mediat sociale lidhur me konfliktin Izrael-Hamas, në gjuhën serbe u publikua një përmbajtje e paverifikuara lidhur me një incident në një kishë për të cilën u pretendua pa fakte se është bërë nga shqiptarët.

04. Mashtrim

Të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga publikues të ndryshëm në mediat sociale. Mashtrimet janë publikuar nga fusha sociale ndërlidhur me publikimet për lojë shpërblyese duke u përdorur figura e boksierit, Florian Markut dhe këngëtares Leonora Jakupi, si dhe publikimin mashtrues për shpërndarje të parasë për audiencën duke u përdorur figura e Behgjet Pacollit. Ndërkaq nga fusha e politikës u publikua fotografi e edituar ku shihet portreti i ish-presidentit Thaçi në një mbledhje të LDK-së.

06. Clickbait / Manipulim i fakteve


Përmbajtja e publikuar në media reale e cila është vlerësuar clickbait / manipulim i fakteve kishte të bënte me dorëheqjen e Blerim Velës, ish-stafit të presidencës së Kosovës.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Temat kryesore që kanë mbizotëruar këtë muaj janë rastet e ndryshme tragjike (vdekje, vrasje) dhe konflikti Izrael-Hamas. Përderisa në muajin tetor kishte mbizotëruar tema e konfliktit Izrael-Hamas (49%), pasuar nga rastet tragjike (6%), gjatë muajit nëntor kemi ndërrim të pozitive ku tema e rasteve tragjike radhitet e para (23%) duke u pasuar nga tema e konfliktit Izrael-Hamas (20%).

Publikimet në kronikën e zezë me vlerësime si “clickbait” patën rritje këtë muaj. Arsyeja kryesore ishte se publikues të ndryshëm përdorën ngjarje të këtij lloji nga vende të ndryshme, duke synuar që, duke mos e përcaktua vend-ngjarjen përmes titullit, t’i paraqesin ato si ngjarje që kanë të bëjnë me Kosovën apo rajonet shqipfolëse. Ndërsa, përkundër faktit se konflikti Izrael-Hamas po vazhdon, përmbajtjet keqinformuese lidhur me ngjarjen kanë pësuar në përmbajtjet në gjuhën shqipe, duke bërë që kjo temë të reduktohet në ekosistemin keqinformues.

Armatosja e FSK-së vazhdon në pozitën e tretë sa i përket temave për të cilat u keqinformua më shumë. Ashtu si në muajin tetor, edhe në muajin nëntor kjo temë ka zënë vendin e tretë me 5%. Lidhur me këtë temë u pretendua pa fakte për pajisjen e FSK-së më armë të ndryshme duke filluar nga automjete ushtarake, aeroplanë, helikopterë etj. Përmbajtjet keqinformuese lidhur me furnizime tjera më armë po qarkullojnë ende në mediat sociale. Kjo për arsye se informacione me këtë temë, pas lajmeve për blerjen e dronëve gjatë muajit qershor, duken të jenë atraktive për audiencën.

Po ashtu, gjatë muajit nëntor ka pasur keqinformim lidhur me tema si: termet në Shqipëri, punë në Zvicër dhe lojë shpërblyese.



57% e temave kryesore janë për raste tragjike në rrethana të ndryshme, konfliktin Izrael-Hamas, armatosjen e FSK-së, termet në Shqipëri, punë në Zvicër dhe lojë shpërblyese.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hybrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Raste tragjike (vdekje, vrasje)

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me artikujt për këtë tematikë janë publikuar në fushën e kronikës së zezë dhe janë vlerësuar si “clickbait”, lajm i rremë dhe dezinformatë. Këta artikuj janë publikuar kryesisht në portale informative, pasuar nga portale të dyshimta dhe publikues në mediat sociale në gjuhën shqipe. Artikujt në kuadër të kësaj temë të keqinformimit kanë trajtuar raste tragjike si vdekje, vrasje, aksidente dhe fatkeqësi në rrethana të ndryshme dhe për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes me synim për të nxitur klikime nga lexuesit.

03. Armatosja e FSK-së

Të gjitha përmbajtjet e trajtuara lidhur me këtë temë, janë publikuar nga publikues të ndryshëm në TikTok. Këto përmbajtje me pretendimet se FSK-ja është furnizuar me automjete ushtarake, helikopterë dhe aeroplanë nga fusha e sigurisë janë vlerësuar si lajm i rremë.

02. Konflikti Izrael-Hamas

Përmbajtjet keqinformuese të trajtuara lidhur me konfliktin Izrael-Hamas janë publikuar nga publikues të ndryshëm në mediat sociale në gjuhën shqipe. Përmbajtjet e tilla u publikuan në fushën e sigurisë dhe të sociale të cilat u vlerësuan si dezinformatë, përmbajtje e paverifikuar dhe lajm i rremë. Nga llogari dhe faqe në mediat sociale, në gjuhën shqipe janë publikuar imazhe dhe fotografi me pretendimin të paraqesin situata apo gjendje nga konflikti.

04. Veriu


Lajmet e vjetra lidhur me temën se Zvicra po kërkon punëtorë vazhdojnë të ri-publikohen në portale të dyshimta me pretendimin të paraqiten si aktuale, e të cilat janë vlerësuar si dezinformatë.

Llojet e fushave

Rezultatet e monitorimit për muajin nëntor 2023 tregojnë se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e sigurisë. Temat kryesore të cilat kanë mbizotëruar nga fusha e sigurisë janë, armatosja e FSK-së dhe konflikti Izrael-Hamas.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sigurisë kanë mbizotëruar edhe në këtë muaj (nëntor), ashtu si në muajin paraprak (tetor), por me një rënie të konsiderueshme prej 23% (52% në tetor ndërsa 29% në nëntor). Vazhdimi i konfliktit Izrael-Hamas i nisur me 7 tetor si dhe keqinformatat lidhur me armatosjen e FSK-së ka ndikuar që keqinformimet në fushën e sigurisë të mbizotërojnë gjatë këtij muaji. Ajo pasohet nga kronika e zezë e cila paraqitet me një rritje të konsiderueshme me 19% krahasuar me muajin paraprak (nga 9% në tetor në 28% në nëntor). Kjo vjen si rezultat i publikimit të përmbajtjeve të vlerësuar si “clickbait” për raste të ndryshme tragjike. Këto dy fusha përbëjnë më shumë së gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në ekosistemin keqinformues.

Artikujt keqinformuese në fushën sociale tregojnë se ka ndryshim prej muajit paraprak (tetor) sa i përket përqindjes. Përderisa gjatë muajit tetor me 9% radhitej e treta, në muajin nëntor fusha sociale po ashtu radhitet e treta por kësaj radhe më një rritje prej 19%. Fusha e politikës krahasuar me muajin paraprak ka pësuar rënie prej 9% ë, (nga 21% si e dyta në muajin tetor 2023, tani në 12% si e katërta në muajin nëntor 2023).

Shumica e publikimeve keqinformuese me përmbajtje të sigurisë janë publikuar nga mediat sociale me 28%, pasuar nga media reale me 2%. Në fushën e sigurisë, 14% e përmbajtjeve keqinformuese janë dezinformatë, 9% lajme të rreme, 5% përmbajtje e paverifikuara dhe 2% “clickbait”. Dezinformatat, lajmet e rreme dhe përmbajtjet e paverifikuara janë publikuar nga publikues në mediat sociale, ndërsa artikujt “clickbait” janë publikuar në media reale. Temat që dominuan ishin konflikti Izrael-Hamas dhe armatosja e FSK-së.

Përmbajtjet keqinformues nga fusha e kronikës së zezë më së shumti janë vlerësuar si “clickbait” (23%), pasuar nga lajmi i rremë (3%) dhe dezinformatë (2%). Pothuajse të gjitha përmbajtjet “clickbait” janë publikuar nga media në gjuhën shqipe lidhur me raste tragjike si vdekje dhe vrasje në rrethana të ndryshme, aksidente, vrasje, vdekje e plagosje. Ndërsa lajmet e rreme dhe dezinformatat janë publikuar në portale të dyshimta dhe media sociale.

Shumica e artikujve keqinformues me tema sociale janë publikuar nga publikues në media sociale në gjuhën shqipe në të cilat mbizotërojnë përmbajtjet mashtruese (6%) lidhur me lojë shpërblyese duke përdor figurat e këngëtarëve dhe përmbajtjet e paverifikuara (6%) nga konflikti Izrael-Hamas. Edhe dezinformata dhe lajmi i rremë janë publikuar lidhur me konfliktin Izrael-Hamas.

Kurse, keqinformimet për politikën janë publikuar nga media, portale të dyshimta dhe publikues në mediat sociale të cilat janë vlerësuar si dezinformatë (5%), mashtrim (3%), lajm i rremë (2%), clickbait (2%) dhe clickbait/dezinformatë (2%).



92% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë për sigurinë, kronikën e zezë, socialen dhe politikën.

Llojet e publikuesve



4

Ngjashëm si në muajin paraprak (tetor 2023), edhe gjatë muajit nëntor 2023, numri më i madh i artikujve keqinformues të trajtuar janë publikuar nga mediat sociale prej 52%. Krahasuar me muajin tetor, mediat sociale kanë pësuar rënie prej 21% (nga 73% në tetor 2023, në 52% në muajin nëntor 2023). Ndërsa mediat reale kanë pësuar një rritje prej 11% (nga 27% në tetor 2023, në 38% në muajin nëntor 2023) si rezultat i publikimit të pothuajse të gjithë artikujve “clickbait” në mediat reale. Po ashtu, gjatë muajit nëntor 10% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë publikuar në portale të dyshimta, të cilat munguan gjatë muajit tetor.

Sipas matjeve të këtij muaji, 52% e artikujve keqinformues janë krijuar e shpërndarë nga publikues të ndryshëm në mediat sociale, 38% nga mediat reale dhe 10% nga portale të dyshimta.

Krahasuar me muajin paraprak vërehet se këtë muaj ka pasur rënie prej 21% të përmbajtjeve që janë publikuar në mediat sociale, rritje prej 11% të artikujve të publikuar në media reale, ndërkaq portalet e dyshimta rikthehen më 10% pas mungesës në muajin paraprak.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




90% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit media sociale (52%) dhe në mediat reale (38%).

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Edhe gjatë këtij muaji, publikimet e ndryshme në gjuhën shqipe janë trajtuar më së shumti si përmbajtje keqinformuese, pra, 97% që ndërlidhen me zhvillimet për dhe rreth Kosovës. Kjo është e kuptueshme marrë parasysh se mostra e monitorimit nga platforma “hibrid.info” fokusohet më tepër tek përmbajtjet që ndërlidhen me Kosovën. Gjithashtu kjo mostër është më e gjerë sa i përket përmbajtjeve në gjuhën shqipe nga mediat reale, publikuesit në mediat sociale dhe portalet e dyshimta, ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës.

Bazuar në të dhënat e monitorimit, 52% e përmbajtjeve në gjuhën shqipe janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale, ndërsa 35% në media reale dhe 9% në portale të dyshimta. Ndërsa, të gjitha keqinformatat në gjuhën serbe janë publikuar në media reale (3%).

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Përmbajtje keqinformuese të trajtuara në gjuhën shqipe gjatë muajit nëntor janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale, ndërsa 35% në media reale dhe 9% në portale të dyshimta. Ndërsa në muajin tetor përmbajtjet e paverifikuara kanë mbizotëruar, në muajin nëntor artikujt “clickbait” radhiten të parat për shkak se të gjitha përmbajtjet nga kronika e zezë janë vlerësuar me këtë kategori. Kjo pasohet nga dezinformata me 25%, për të vazhduar më lajmin e rremë me 17%. Sa i përket fushave, 29% prej tyre janë publikuar nga fusha e sigurisë me 29%, pasuar nga kronika e zezë me 28% dhe sociale 22%.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të trajtuara në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat reale që kanë trajtuar tema të sportit dhe sociale. Publikimet e mediave në gjuhën serbe janë vlerësuar si dezinformata dhe përmbajtje e paverifikuara. Përderisa dezinformata kishte të bënte me pretendimin për mosparaqitjen e portierit të kombëtarës së Izraelit në futboll në ndeshje kundër Kosovës, përmbajtja e paverifikuara kishte të bënte më një incident në një kishë ortodokse në Bardhosh ku pretendohet pa fakte se është bërë nga shqitarët.

6

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Ngjashëm si në muajin paraprak (tetor 2023), edhe në muajin nëntor 2023 prijnë përmbajtjet keqinformuese të publikuesve në Facebook, por duke pësuar rënie prej 34% (nga 88% sa ishte në tetor në 54% në nëntor). Ndërsa, keqinformimet në TikTok kanë shënuar një rritje gjatë muajit nëntor 2023 prej 34% krahasuar me muajin tetor (nga 12% sa ishte në tetor 2023, në 34% në nëntor 2023).

Kështu që, 54% e përmbajtjeve keqinformuese u publikuan dhe shpërndanë në Facebook, pasuar nga TikTok me 46%.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Keqinformata në gjuhën shqipe, gjatë muajit nëntor 2023, më së shumti u publikuan nga faqet e ndryshme në Facebook (40%), pasuar nga llogaritë (11%). Edhe gjatë këtij muaji 2023, faqet në Facebook kanë mbizotëruar sa i përket shpërndarjes së artikujve keqinformues, duke u pasuar nga llogari në TikTok (46%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Keqinformatat e trajtuara të publikuara në gjuhën shqipe në Facebook kategorizohen si dezinformata (23%), mashtrim (14%), përmbajtje e paverifikuar (14%) dhe lajm i rremë (3%). Shumica e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në Facebook janë nga fusha sociale dhe politike. Pjesa dërrmuese e publikimeve keqinformuese nga fusha e politikës përshinë dezinformata dhe përmbajtje të paverifikuara lidhur me konfliktin Izrael-Hamas. Ndërsa artikujt me tematikë sociale ndërlidhen me dezinformata dhe përmbajtja të paverifikuara rreth zhvillimeve me karakter social nga konflikti Izrael-Hamas, si dhe keqpërdorimet e figurave të njohura të Kosovës në publikime mashtruese që pretendohej të paraqiteshin si lojë shpërblyese në Facebook.


02. TikTok

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese e trajtuara të publikuara nga llogari në TikTok janë në fushën e sigurisë të cilat janë vlerësuar si lajm i rremë dhe dezinformata. Në TikTok u publikuan lajme të rreme me pretendime për pajisjen e FSK-së me armatime të ndryshme si, helikopterë e aeroplanë. Ndërsa dezinformatat përfshinë publikime me pretendime për sulm në veri, një deklaratë të shpikur të ministrit Hekuran Murati rreth pagës së policëve, si dhe pretendimin dezinformues për ndalim hyrjen në SHBA të imamit Elvis Naçi.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Institucionet e sigurisë vazhdojnë të jenë më të përfolurat në keqinformatat e krijuara dhe të shpërndara nga publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) u përfol në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale (TikTok) me pretendimet se FSK-ja do të pajiset me automjete ushtarake, helikopterë dhe aeroplanë.

Policia e Kosovës është institucioni i dytë më i përfolur në përmbajtjet keqinformuese. Ky institucion u përfol në një postim në TikTok rreth pagave të tyre ndërlidhur me një deklaratë të manipuluar të ministrit Hekruan Murati.

Të gjitha institucionet e përmendura në tabelën e mësipërme janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga publikues të ndryshëm gjatë muajit nëntor 2023.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Presidenti i SHBA-së, Joe Biden, presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi janë figurat më të përfolura[SO1] në keqinformimet e publikuara në muajin nëntor.

Biden u përfol në mediat sociale dhe portale të dyshimta. Këta lloje publikuesish krijuan e shpërndanë artikuj që përmbanin një deklaratë të pathënë për Kosovë dhe një fotografi të montuar lidhur me personalitetin e tij. Erdogan u përfshi në lajmet e rreme të publikuara në TikTok lidhur me furnizimin me armë të FSK-së, ku pretendohet pa fakte se kjo do të bëhet nga Turqia. Ish-presidenti, Hashim Thaçi, u përfol në TikTok ku u publikua një imazh i montuar i tij në një mbledhje të LDK-së, si dhe u dezinformua rreth gjendjes shëndetësore të tij në Hagë.


Personalitetet si Behgjet Pacolli, Leonora Jakupi dhe Florian Marku u përfolën në përmbajtjet mashtruese në mediat sociale (Facebook) me pretendime mashtruese për lojë shpërblyese dhe shpërndarje të parasë për ndjekësit.

Personalitete e figura tjera të përfolura janë Ardon Jashari, Angeline Jolie, Hekuran Murati, Blerim Vela, Isa Boletini, Elvis Naçi, Sylvester Stallone, Ganimete Musliu dhe

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE



Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit tetor, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar dy deklaratat premtuese.

Xhelal Sveçla, ministri i Punëve të Brendshme duke aluduar në pjesëtarët e Njësitit Special Intervenues (NjSI) të Policisë së Kosovës, në një status në Facebook, ka shkruar se të ardhurat mesatare për këta zyrtarë gjatë këtij viti kalojnë shumën e 2200 eurove. Hibrid.info ka vërtetuar se, në bazë të Ligjit të Pagave për zyrtarët publikë, asnjë nga pozitat brenda Policisë së Kosovës nuk paguhet në shumën e pretenduar nga ministri Sveçla si dhe, po ashtu, është gjetur se pagesa e pretenduar ka përfshirë policët e angazhuar në veri të vendit, për shkak të orarit të zgjatur të punës.

Regjistrimi i popullsisë parashihej të fillonte me 1 nëntor të vitit 2023, në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës. Vendimin e ka konfirmuar edhe kryeministri Kurti me anë të një deklaratë. Por, pas verifikimit të fakteve nga hibrid.info është vërtetuar se vendimi nuk ka nisur së zbatuari ende.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 nëntor 2023, në të cilën janë trajtuar 88 përmbajtje keqinformuese.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit nëntor 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit nëntor 2023, mediat dhe publikuesit e ndryshëm kanë publikuar më së shumti artikuj “clickbait” me 32%, pasuar nga dezinformata me 26% dhe lajmi i rremë me 17%, ndërsa përmbajtjet mashtruese zënë vendin e katërt me 11%. Pjesa më e madhe e përmbajtjeve “clickbait” janë krijuar e publikuar në fushën e kronikës së zezë me 23% dhe sociale me 3%, dhe të gjitha janë publikuar në media reale. Ndërsa, dezinformatat janë publikuar nga publikues në media sociale, portale të dyshimta dhe media reale në gjuhën shqipe, ku pjesa dërrmuese e tyre janë nga fusha e sigurisë, politikës dhe sociale. Pothuajse të gjitha lajmet e rreme janë publikuar në mediat sociale, shumica prej tyre në fushën e sigurisë dhe kronikës së zezë. Të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale lidhur me temat sociale dhe politike. Pra, në momentin kur nuk ka ndonjë zhvillim të madh në Kosovë, atëherë artikujt “clickbait” rikthehen si formë e çrregullimit informativ më idenë e nxitjes së klikimeve, e që praktikohet nga portale informative. Ndërsa, dezinformatat vazhdojnë të publikohen në mediat sociale përfshirë tema dhe diskutime të vjetra duke intervenuar në to (ndryshime në tituj dhe përmbajtje).

Rastet e ndryshme tragjike duke përfshirë vdekje, vrasje, aksidente, si dhe konflikti Izrael-Hamas ishin dy temat kryesore të keqinformimit gjatë këtij muaji. Artikujt në kuadër të rasteve tragjike të keqinformimit kanë trajtuar vdekje, vrasje, aksidente dhe fatkeqësi në rrethana të ndryshme dhe për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes me synim për të nxitur klikime nga lexuesit, e të cilat kryesisht janë vlerësuar si “clickbait” dhe janë publikuar në portale informative. Ndërsa, sa i përket konfliktit Izrael-Hamas, në mediat sociale janë publikuar kryesisht dezinformata dhe lajme të rreme nga fusha e sigurisë dhe sociale, ku në shumicë të madhe përfshiheshin imazhe dhe fotografi me pretendimin se paraqesin gjendjen nga ky konflikt. Përkundër faktit që konflikti Izrael-Hamas po vazhdon, përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga faqe dhe llogari në mediat sociale lidhur me të janë reduktuar. Kjo hap rrugë që tematikat tragjike të e dominojnë ekosistemin keqinformues në Kosovë.

Përkundër faktit që nuk ndërlihen njëra me tjetrën siguria, kronika e zezë dhe fusha sociale, këto tri fusha përbëjnë pjesën dërrmuese (80%) të përmbajtjeve keqinformuese të publikuar për muajin nëntor 2023.

Shumica e përmbajtjeve keqinformuese nga fusha e sigurisë u vlerësuan si dezinformata (14%) dhe lajm i rremë (9%) dhe u publikua në mediat sociale. Ndërsa, përmbajtjet keqinformuese nga kronika e zezë kryesisht janë publikuar në media reale, e që shumica prej tyre u vlerësuan “clickbait”. Përmbajtjet lidhur me armatosjen e FSK-së dhe rreth konfliktit Izrael-Hamas kanë bërë që siguria të mbizotërojë gjatë këtij muaji, ndërsa artikujt “clickbait” janë publikuar nga fusha e kronikës së zezë, pra për raste të ndryshme tragjike. Edhe pjesa dërmese keqinformative nga fusha sociale u publikuan në mediat sociale ku mbizotëruan mashtrimet, përmbajtjet e paverifikuara dhe dezinformatat sa i përket kategorive. Fushat tjera të keqinformimit përfshijnë politikën (12%), sportin (5%), kulturën (2%) dhe shëndetësinë (1%).

Edhe gjatë muajit nëntor 2023, keqinformatat e publikuara në mediat sociale kanë mbizotëruar me 52%, duke u pasuar nga mediat reale (38%) dhe portalet e dyshimta me 10%. Në muajin nëntor, në bazë të mostrës monitoruese, 97% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga media dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe, ndërsa 3% në mediat në gjuhën serbe. Pjesë dërmuese e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe janë nga fusha e sigurisë, kronikës së zezë dhe sociale, ndërsa ato në gjuhën ishin nga fusha sociale dhe e sportit. Përderisa pjesa më e madhe e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe janë vlerësuar si “clickbait”, dezinformata dhe lajm i rremë, ato në gjuhën serbe u kategorizuan si dezinformata dhe përmbajtje e paverifikuar. Sa i përket publikimeve nga publikuesit në media sociale, 54% janë publikuar në Facebook, duke u pasuar nga TikTok me 46%.

Joe Biden, Recep Tayyip Erdogan dhe Hashim Thaçi janë tre figurat më të përfolura në keqinformatat e publikuara nga publikuesit në gjuhën shqipe. Si institucion, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) u përfshinë në keqinformatat e publikuara gjatë nëntorit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk e mbajti premtimin e deklaruar më 27 tetor, se procesi i regjistrimit të popullsisë do të fillojë me datën e paraparë (1 nëntor) në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës, vendim ky i pa zbatuar.

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë deklaratë gjysmë të vërtetë duke shkruar se të ardhurat mesatarë për këta zyrtarë gjatë këtij viti kalojnë shumë e 2200 eurove, edhe pse në bazë të Ligjit të Pagave për zyrtarët publikë, asnjë nga pozitat brenda Policisë së Kosovës nuk paguhet në shumë e pretenduar nga ministri Sveçla si dhe po ashtu është gjetur se pagesa e pretenduar ka përfshirë policët e angazhuar në veri të vendit, për shkak të orarit të zgjatur të punës.

HIBRIDO.INFO